

K Ë R K E S Ë

PËR SHPALLJEN TË VDEKUR TË MUSA KRANJËS

GJYKATËS SË RRETHIT TË TIRANËS

Kërkuesi: Genc Musa Kranja, datëlindja 1943, banues në Tiranë, Rr."Llazi Miho" pallati 156
Objekti: Shpalljen si të vdekur të babait tim Musa Kranja, në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Në muajin nentor 1944 babai im Musa Kranja është larguar nga Shqipëria në drejtim të Italisë, duke lënë këtu në Tiranë gruan dhe mua djalin e tij.

Fillimisht nuk patëm asnjë lajm për të, dhe pas dy vjetësh më 1946 nga disa njerëz mësuam se babai im ishte vrarë në zonat ku zhvillohej lufta civile në Greqi.

Që nga ajo kohë deri më sot, pas 52 vjetësh nuk kemi marrë asnjë njoftim tjetër zyrtar apo gojor për fatin e tij.

Në këto kushte, konform ligjit, kërkoj nga gjykata shpalljen e tij si të vdekur.

KËRKUESI
Genc Kranja